




REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT / ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. 2-D/DPK	Nr Prot. 01-993/13
Dep. 02	Prot. No. 04.04.2013
Nr. f.faq.	Data
Broj. stranica	Datum
Nr. pages	Dati



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosova**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE**  
**ANTI - CORRUPTION AGENCY**

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika e) të Rregullores së Punës të Agjencisë Kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë Kundër Korrupsionit me datë **27.03.2013**, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

**I. Mbyllet rasti me Nr. AKK-03-241/13, për znj. *Hajrije Hysenaj – Honduzi, Prodekane në Fakultetin e Mjeksisë në Universitetin e Prishtinës, për shkak se është parandaluar situata e mundshme e konflikti të interesit në ushtrimin e funksionit publik.***

**II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.**

**A r s y e t i m**

**I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në ushtrimin e funksionit publik, nr. AKK-03-241-13, për Zyrtares e lartë, znj. Hajrije Hysenaj - Honduzi – Prodekane në Fakultetin e Mjeksisë në Universitetin e Prishtinës, dhe njëkohësisht person i autorizuar i një biznesi privat, është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji Nr. 04/L-051).**

Në këtë rastin të trajtuar, zyrtares së lartë të dyshuar për ekzistimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, znj. Hyseni - Honduzi i është dërguar njoftimi me një shkresë zyrtare nga Agjencia, pas të cilës znj. Hyseni – Honduzi ka sjellur dokument zyrtar nga Agjencioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë, se ndërmmarrja - Ambulanta e Terapisë Fizike “Fizo Plus”, ndërkohë, me vetiniciativë është shuar në mënyrë vullnetare (DPKI-03/816/13), dhe rrjedhimisht është parandaluar konflikti i mundshëm i interesit në ushtrimin e funksionit publik, dhe tani për tani gjendja e tillë më nuk ekziston.

**II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë Kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.**

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari kontaktues)

Drejtor i Agjencisë Kundër Korrupsionit

/ Hasan Preteni /

